



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

BUXHETI PËR QYTETARËT 2023

Ky material mbështetet në Ligjin Nr. 84/2022 për Buxhetin e Vitit 2023, i miratuar në datën 24.11.2022 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ky material paraqet një variant të përmbledhur dhe jo shterues të buxhetit 2023.

Përdorimi i tekstit

Përdorimi i tekstit dhe të dhënave të paraqitura në këtë material, me kusht që të referohen pandryshim, lejohet me citimin e burimit:

Burimi

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Modifikimi i tekstit

Në rast se teksti, të dhënat apo grafikët e paraqitur këtu përdoren për të gjeneruar material apo të dhëna të ndryshme, preferohet citimi:

Bazohet në të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Informacione të tjera

Projektligji i plotë për Buxhetin 2023 dhe tabelat përkatëse janë botuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave:

www.financa.gov.al

Për informacione apo sqarime të nevojshme mund të drejtoheni në adresën: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

e-mail: konsultimepba@financa.gov.al

Paraqitja grafike nga HL Branding

Botimi i këtij dokumenti u mundësua me mbështetjen e Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore (UN Women) në kuadër të projektit rajonal "Financimi transformues për barazinë gjinore drejt një qeverisjeje më transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor", i financuar nga Qeveria e Suedisë - SIDA.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikimin nuk përfaqësojnë detyrimisht pikëpamjet e UN Women apo Qeverisë Suedeze.



SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY



2023

BUXHETI PËR QYTETARËT

Një vështrim i thjeshtëzuar në financat publike për vitin 2023

Tabela e përmbajtjes

Mesazh për lexuesin

06

Mesazh i Ministres së Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj

Të dhëna demografike

08

- Punësimi
- Rritja ekonomike
- Politikat prioritare të qeverisë dhe financimi i shpenzimeve buxhetore për realizimin e tyre
- Për çfarë shpenzohen paratë e buxhetit të shtetit?

“Projektbuxheti 2023 është **buxheti i mbështetjes e rritjes së qëndrueshme ekonomike** dhe konsolidimit të pandalshëm fiskal për një ekonomi dhe shoqëri të shëndetshme!”

Delina Ibrahimaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Politikat prioritare të qeverisë dhe financimi i shpenzimeve buxhetore për realizimin e tyre

11

Deficiti buxhetor dhe borxhi publik

26

- Shërbimet e përgjithshme publike 12
- Bujqësia dhe zhvillimit rural 13
- Mbështetja e zhvillimit ekonomik 14
- Infrastruktura dhe energjia 15
- Shëndetësia 17
- Arsimi 18
- Mbrojtja sociale 20
- Drejtësia dhe rendi 21
- Mbrojtja 22
- Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare 23
- Mbrojtja e mjedisit 24
- Strehimi dhe komoditetet e komunitetit 25

BUXHETI PËR QYTETARËT 2023

Mesazh për lexuesin



Delina Ibrahimaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Të nderuar qytetarë të Shqipërisë,

Dëshiroj t'ju njoh shkurtimisht dhe në mënyrë të thjeshtuar me propozimin e buxhetit të shtetit për vitin 2023. Ky projektbuxhet synon të konsolidojë, nga njëra anë rritjen ekonomike dhe uljen e stokut të borxhit publik, dhe nga ana tjetër të minimizojë sa më shumë që të jetë e mundur efektet negative të luftës në Ukrainë në ekonominë e vendit dhe më gjerë. Deri më tani, ekonomia jonë e ka përballuar relativisht mirë edhe këtë goditje, në vijim të goditjeve nga tërmeti e pandemia, veçanërisht duke e parë atë në kontekstin e problemeve që po kalon pjesa dërrmuese e ekonomive në botë.

Çështja kryesore makroekonomike gjatë kësaj periudhe edhe për ekonominë tonë, si pothuajse kudo tjetër, ka qenë inflacioni i lartë i shkaktuar kryesisht nga goditja në ofertën globale të disa mallrave bazë. Pikërisht për të minimizuar sa më shumë që të jetë e mundur efektet e inflacionit, Qeveria Shqiptare vijon masat mbrojtëse për qytetarët për vitin 2023 duke mbajtur të pacënuar çmimin e energjisë elektrike për familjet dhe shumicës së bizneseve duke mbështetur sektorin elektroenergjitik me 12 miliardë lekë, në vijim të mbështetjes së qënësishme gjatë vitit 2022, si dhe duke ofruar më shumë mbështetje financiare për shtresat më vulnerabel të shoqërisë.

Për vitin 2023, të ardhurat totale buxhetore për vitin 2023 parashikohen të arrijnë 631.7 miliardë lekë, me një rritje prej 7.7% krahasuar me të pritshmin e vitit 2022. Dëshiroj të theksoj këtu një politikë fiskale që do të zbatohet për vitin 2023 nga e cila përfitojnë drejtpërdrejt 70 mijë qytetarë me pagë nga 40 mijë lekë deri në 50 mijë lekë në muaj të cilëve nuk do u mbahet tatimi mbi të ardhurat personale. Bazuar në projeksionet e të ardhurave të vitit 2023, totali i të ardhurave të buxhetit shkon në 29% e PBB-së nga 28.2% në vitin 2022, pra më rritje 0.8% e PBB-së. Ky programim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe reformat fiskale në proces, të cilat mbështesin në këtë mënyrë rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Në krahun e shpenzimeve buxhetore, në projektbuxhetin e vitit 2023 janë parashikuar të shpenzohen 687.2 miliardë lekë ose 31.6% e PBB, me një rritje në vlerë absolute prej 26.5 miliardë lekë krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2022. Shpenzimet për vitin e ardhshëm do të përqendrohen në financimin e sektorëve prioritarë si: arsimit, shëndetësia, infrastruktura dhe shërbimet dixhitale, infrastruktura dhe bujqësia. Shpenzimet buxhetore për këtë vit do të vijojnë të orientohen drejt arritjes dhe ruajtjes së standardeve të kërkuara nga procesi i integritetit të vendit tonë në familjen e Bashkimit Europian. Rreth 9% e shpenzimeve të përgjithshme do të financojnë politika me ndjeshmëri të lartë gjinore që synojnë jo vetëm ndihmën dhe mbështetjen ndaj vajzave dhe grave nga të gjitha grupet sociale, por edhe të ngushtojë hendeqet gjinore në të gjitha fushat e jetës, në mënyrë që askush të mos mbetet pas.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2023, janë parashikuar në masën 65.5 miliardë lekë, me një rritje prej 9% më shumë se buxheti i vitit 2022. Këto shpenzime për vitin 2023, zënë rreth 3% të PBB-së nga 2.3% që zinin në vitin 2013. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vitin 2023 do të vijojë me reformimin e financave publike vendore, duke u fokusuar në rritjen e investimeve, digjitalizimin e operacioneve të menaxhimit financiar në nivel vendor, rritjen e të ardhurave nga taksat vendore, si dhe në reformimin e skemave të financimit të qeverisjes vendore.

Rritja e pagave për gratë dhe burrat që punojnë në administratën qendrore dhe vendore, mbështetja për sektorin e energjisë, rritja shpenzimeve për gratë dhe burrat në nevojë, etj janë vetëm disa nga angazhimet kryesore që ky buxhet synon të arrijë në përm-bushje të detyrimeve të Qeverisë ndaj qytetarëve dhe qytetarëve të Shqipërisë.

Projektbuxheti 2023 është buxheti i mbështetjes e rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe konsolidimit të pandalshëm fiskal për një ekonomi dhe shoqëri të shëndetshme!

Projektbuxheti
2023 është
**buxheti i
mbështetjes
e rritjes së
qëndrueshme
ekonomike**
dhe
konsolidimit të
pandalshëm
fiskal për një
ekonomi dhe
shoqëri të
shëndetshme!

Të dhëna demografike


Sipas të dhënave të INSTAT për Janar 20221 nuk priten ndryshime të qenësishme në rritjen e popullsisë duke mbetur në nivelin e 2.8 milionë banorë që jetojnë brenda kufijve të Shqipërisë, nga të cilët 1,406,532 janë gra dhe vajza (ose 50.3%) dhe 1,387,060 burra dhe djem (ose 49.7%). Rreth 23% e popullsisë përbëhet nga gra/vajza dhe burra/djem të moshës 20-34 vjeç, prej të cilëve/cilave 49,6 % janë gra dhe vajza (37% e të cilave janë të moshës 25-29 vjeç). Jetëgjatësia mesatare për vitin 2021 ishte 74.4 vjeç për burra dhe 78.7 vjeç për gratë. Tirana vijon të jetë qarku me popullsinë më të lartë në vend me 919,511 banorë, nga të cilët 466,718 gra dhe vajza (ose 51%) dhe 452,793 burra dhe djem (ose 49%) e ndjekur nga Durrësi (291,325 banorë, 50% gra dhe 50% burra) dhe Elbasani (259,112 banorë, 51% gra dhe 49% burra).

Punësimi

Referuar statistikave gjinore të INSTAT2 për vitin 2021 numri mesatar i orëve të shpenzuara në punën e brendshme të papaguar sipas gjinisë është 5 orë e 43 minuta për gratë/vajzat dhe 2 orë e 6 minuta për burrat/djemtë. Në tremujorin e dytë 2022, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 64,4 %. Në tremujorin e dytë 2022, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, për popullsinë 15-64 vjeç, është 72,8 %. Ndërkohë, norma e pjesëmarrjes në forcën e punës për grupmoshën 15-24, sipas gjinisë është 31.5% për gratë dhe 41.1% për burrat. Në tremujorin e dytë të vitit 2022 numri i grave dhe burrave të punësuar në moshë pune (15-64 vjeç) ishte 1,222,734. Nga këta, 84,762 gra dhe burra punojnë në administratën shtetërore qendrore dhe 34.000 gra dhe burra të punësuar

në administratën vendore që paguhen nga buxheti i shtetit. 12.4% e grave të moshës 15-64 vjeç janë të papunësuar kundrejt 11.8% e burrave të të njëjtës grupmoshë. 55.5% të të punësuarve në vend janë burra, nga të cilët 28.8% punojnë në bujqësi dhe 44.5% janë gra, 40% e të cilave punojnë në bujqësi, ndërkohë që 25% të grave të moshës 15-64 vjeç janë të punësuar në biznese familjare dhe shpeshherë të papaguara për punën e kryer (kundrejt 12.9% të burrave të po kësaj moshe që kryejnë të njëjtin aktivitet). Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të dytë 2022, është 60.666 lekë, duke u rritur me 7,0 % krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. Hendeku gjinor i pagave është 4.5%. Raportit përfitues/kontribues të sigurimeve shoqërore për 2023 parashikohet 1.015 nga 1.039 në 2022.

Fig 1 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç, Tr. 2/18 - Tr. 2/22



1. <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>
 2. <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/#tab2>
 3. Hendeku gjinor i pagave është diferenca mesatare midis shpërblimit për burrat dhe gratë që punojnë.

Rritja ekonomike

Rritja ekonomike në vend parashikohet të qëndrojë për një periudhë afatmesme 2023-2025 afër nivelit 3.7%-3.9% me një ngadalësim në 2.6%, për vitin 2023, e ndikuar nga zhvillimet dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian. Gjatë periudhës afatmesme rritja ekonomike pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Konsumi final total për periudhën afatmesme (2023 – 2025) parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 2% në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 1.8% në vit në rritjen e PBB. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real me rreth 3.9% në vitet 2023-2025, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 0.9% në vit.


Inflacioni mesatar pritet të ulet nga 6.5% në 2022 në 3.6% në 2023 ndërsa Prodhimi i Brendshëm Bruto për banor (PBB/banor) pritet të rritet nga 728 mijë lekë për banor në vitin 2022 në 772 mijë lekë për banor në vitin 2023.

Nga vijën të ardhurat e buxhetit?

Në vitin 2023, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 631.711 miliardë lekë (ose 29% të PBB) prej të cilave, të ardhurat tatimore zënë 587.8 miliardë lekë (ose 27% të PBB) dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mbliidhen nga tatimet dhe doganat janë 431.2 miliardë lekë (ose 19.8% të PBB). Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet planifikohen të jenë 127.5 miliardë lekë (ose 5.9% të PBB). Të ardhurat nga pushteti vendor janë parashikuar në vlerën 29,153 miliardë lekë ose 1.3% e PBB.

Të ardhurat nga pushteti vendor janë parashikuar në vlerën 29,153 miliardë lekë ose 1.3% e PBB.

Fig 2 Të ardhurat e buxhetit të shtetit (miliard lekë)



Për çfarë shpenzohen paratë e buxhetit të shtetit?


Shpenzimet Buxhetore për

periudhën 2023-2025 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike prej mesatarisht 5.2% të PBB duke u përqendruar në financimin e projekteve me rëndësi strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë mbështetjen për dixhitalizimin dhe sigurinë kibernetike, finalizimin e projekteve të rrugëve kombëtare, sigurinë kombëtare, mbështetjen e sektorit të energjisë, të ujit, mbrojtjes

sociale, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në kuadër të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, në vitin 2023 do të vijojë adresimi i çështjeve të lidhura me barazinë gjinore kryesisht në fushat e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik. Në këtë projektbuxhet parashikohet që rreth 9% e shpenzimeve të përgjithshme publike ti dedikohen politikave publike me bazë gjinore të përfshira në 47 programe buxhetore. Shpenzimet e personelit për vitin 2023, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, si dhe

politikën e re të rritjes së pagave për sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes (nisur në 1 korrik 2022), si dhe rritjen e pagave për administratën publike (nisur në 1 shtator 2022) me mesatarisht 7%. Fondi vjetor për rritjen e pagave për vitin 2023 është planifikuar në shumën 2.3 miliardë lekë dhe parashikon rritjen e pagës për funksion me 6% për punonjësit e sistemit shëndetësor dhe ata arsimorë, ku pjesa më e madhe e tyre janë gra dhe vajza. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike janë planifikuar në masën 96.8 miliardë lekë ose 4.5% e PBB.

Fig 3 Si shpenzohen të ardhurat e buxhetit të shtetit (miliard lekë)



POLITIKAT PRIORITARE TË QEVERISË DHE FINANCIMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR REALIZIMIN E TYRE

Shtyllat kryesore për përmirësimin e jetesës së grave dhe burrave të të gjitha grupeve sociale në Shqipëri do të jenë: mbrojtja sociale, arsimi, shëndetësia, nxitja e punësimit dhe arsimi profesional të të rinjve dhe të rejave, mbështetja pro-aktive ndaj biznesit, sidomos atij rural dhe turizmit.

1. Shërbimet e përgjithshme publike

Në shpenzimet e këtij funksioni që zënë rreth 5.5% të PBB përfshihen kostot e funksionimit të administratave qendrore dhe vendore si dhe shpenzimet e interesave, fondi i veçantë i pagave dhe shpenzimet e të ardhurave të tjera jashtë limitit.

5260 fermerë përfitues

nga skemat mbështetëse kombëtare dhe IPARD III nga të cilët 776 gra



2. Bujqësia dhe zhvillimi rural

Prioritetet e sektorit të bujqësisë, për periudhën afatmesme 2023-2025, janë si më poshtë:

- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët;
- Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas;
- Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmbytjeve;
- Mbështetje për agroindustrinë;
- Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

Politikat e zhvillimit rural për vitin 2023 do të financohen me rreth 14.2 miliardë lekë ose 0.7% e PBB, ku prioritet do të kenë edhe:

- Rritja me 7% e pagave të administratës shtetërore të sektorit ku rreth 65% janë gra;
- Rritja nga 72.2% në vitin 2022, në 73.6% në vitin 2023 e përqindjes së e burrave dhe grave fermerë, që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës ujtitëse dhe kulluese ndaj totalit të fermerëve në sipërfaqen potencialisht të ujtitshme;
- Përqindja e sipërfaqes ujtitëse ku fermerët kanë akses për ujë për ujitje, kundrejt sipërfaqes potencialisht të ujtitshme (360 000 ha)
- Rreth 7800 fermerë që përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor, prej të cilëve 380 gra;
- 5260 fermerë perfitues nga skemat mbështetëse kombëtare dhe IPARD III nga të cilët 776 gra;
- Përmirësimin e politikave dhe zbatimi i tyre në praktikë për zhvillimin e sektorit të peshkimit, rritjen e numrit të grave të punësuar në këtë sektor dhe përmirësimi i kushteve të tyre të punës;

Politikat e zhvillimit rural për vitin 2023 do të **financohen me rreth 14.2 miliardë lekë** ose 0.7% e PBB

3. Mbështetja e zhvillimit ekonomik

Prioritetet në fushën e mbështetjes së zhvillimit ekonomik do të jenë:

- Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve "Made in Albania";
- Rritja e përpjekjeve për të reduktuar informalitetin e mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si pengesë kyçe në aksesin e financimeve të SME-ve, nëpërmjet:



- ➔ Rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare në tregun ndërkombëtar nëpërmjet granteve nga Fondi i Konkurrueshmërisë, ku prioritet do të kenë bizneset e administruara nga gratë;
- ➔ Avancimit të mëtejshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit nëpërmjet granteve që i akordohen bizneseve të specializuara në këtë fushë nga Fondi i Inovacionit;
- ➔ Nxitjes së krijimit të bizneseve të reja në sektorë me potencial zhvillimi nëpërmjet Fondit Start-Up, ku vajzat dhe gratë do të kenë prioritet në mbështetje të ideve të tyre;
- ➔ Mbështetjes së sipërmarrjeve të sektorit të artizanatit dhe zejtarisë, sektor ky me një përfaqësim të lartë të grave dhe vajzave që ndihmojnë në ruajtjen e traditës dhe kulturë;
- ➔ Konsolidimin në treg dhe rritjen e numrit të të punësuarve gra dhe burra në këto sipërmarrje nëpërmjet "Fondit në mbështetje të biznesit kreativ", ku në total parashikohet të përfitojnë 85 SME vendase me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë deri në 2025.

4. Infrastruktura dhe energjia

Buxheti në dispozicion për prioritetet në këtë fushë është rreth 54.8 miliardë lekë ose 2.5% e PBB dhe ato do të jenë:

Financimi i projektit i Tunelit të Llogarasë në vlerën 6.3 miliardë lekë

- Rritja e numrit të përfituesve direkt dhe indirekt, gra dhe burra, përdorues të rrjetit rrugor, nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikën e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Zgjerimi i aksesit të burrave dhe grave të të gjitha grupeve sociale si dhe rritja e cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes investimeve publike; dhe përmirësimit rrënjësor të menaxhimit (30% të drejtuesve janë gra) të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standardizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e efikasitetit të konsumit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme nga gratë dhe burrat e të gjitha grupeve sociale, përdorues finalë;
- Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet vazhdimin të ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese.



Në programin e rrugëve kombëtare do të financohen me prioritet:

- Mirëmbajtja sipas standardeve të 4044 Km rrugë në territorin e Republikës së Shqipërisë me fond total për shpenzimet e mirëmbajtjes prej 2.6 miliardë lekë;
- Financimi i projektit i Tunelit të Llogarasë në vlerën 6.3 miliardë lekë dhe vazhdimi i projektit madhor "Unaza e Tiranës";
- Vijimi i zbatimit të projekteve koncesionare prioritare si: Rruga e Arbrit në vlerën 2.8 miliardë lekë, Rruga Oriku-Dukat në vlerën 911 milionë lekë.

Shërbimet për ujësjellës e kanalizime do të vijojnë të financohen për të përmirësuar treguesit si më poshtë:

- Furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë në vitin 2025;
- rritja e numrit mesatar të orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar në 14 orë në ditë deri në 2025, nga 12.5 orë në ditë në vitin 2022;
- shtimin dhe përmirësimin e aksesit të grave dhe burrave në shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm në zonat urbane me 95% dhe në zonat rurale me 62% deri në vitin 2025.

Politikat e zhvillimit të energjisë së rinovueshme do të synojnë të:

- Rrisin përdorimin e energjisë së rinovueshme me 38% kundrejt vitit 2022
- Rrisin efikasitetin e energjisë me 6.5% referuar vitit 2021

Vëmendje do t'i kushtohet përmirësimit të cilësisë së jetesës së qytetarëve nëpërmjet realizimit të politikave të mbrojtjes së mjedisit si:

- Trajtimi i 53% të mbetjeve në landfille të sigurta
- Ulja e normës së ndotjes së ajrit në 39 µg/m³ deri në 2025 nga 41 µg/m³ që pritet të arrihet në fund të 2022;
- Rritja e normës së mbetjeve të rikuperuara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të prodhuara në 30% deri në 2025 nga 3% që synohet në fund të 2022;

Planifikimi urban do të zhvillohet duke pasur ne fokus nevojat e grave dhe burrave në zonat urbane dhe rurale për lëvizshmëri dhe infrastrukturë të sigurt duke:

- mbështetur projektet me fokus lokal, rajonal dhe në rang vendi, si dhe hartimin e rregullave teknike në projektim duke i harmonizuar këto plane me PPK, PINS Durana dhe PINS Tiranë Durrës, për një zhvillimit të barabartë të territorit.
- vijuar projektet e përmirësimit të infrastrukturës publike "100 Fshatrat";
- Mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues hekurudhor dhe ndërtimit të linjës së re Tiranë - Durrës dhe Shkodër-Hani Hotit.



5. Shëndetësia

Politikat prioritare të zhvillimit të shëndetësisë do të financohen me rreth 67.3 miliardë lekë ose 3.1% të PBB dhe ato janë:

- Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore) për të gjithë gratë dhe burrat e grupeve të ndryshme sociale;
- Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare të institucioneve shëndetësore e të mbrojtjes sociale, nëpërmjet përdorimit më efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve;



- Rritja e kosto-efektivitetit të listës së barnave e pajisjeve të rimbursueshme ku do të mbështeten 410 mijë qytetarë me barna të rimbursueshme në përgjigje të trajtimit të sëmundjeve kronike dhe impaktit post Covid;
- Financimi i paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike e jopublike për të gjithë gratë dhe burrat e grupeve të ndryshme sociale;
- Pagesat për kujdes shëndetësor për të gjithë gratë dhe burrat e grupeve të ndryshme sociale, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;
- Kostimi i shërbimeve të reja shëndetësore, me synim ndryshimin e mënyrës së financimit të shërbimeve shëndetësore;
- Financimi i shërbimit të kontrollit bazë mjekësor duke përfutur falas analiza dhe kontrole periodike për 490 mijë qytetar në vit, gra dhe burra të grupeve të ndryshme sociale të moshës 35-70 vjeç;

Politikat shëndetësore do të vijojnë të mbështesin nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor dhe dytësor, ku rëndësi të veçantë zënë investimet në maternitetet e reja me rreth 508,287,149 lekë. Do të shtohet numri i:

- grave dhe vajzave të moshës mbi 35 vjeç që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të gjirit (37% kryhet nga shërbimet e shëndetit dytësor dhe 15.2% nga shërbimet e shëndetit publik);
- grave dhe vajzave të moshës 40-65 vjeç që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të qafës së mitrës në 9.5%;
- Rasteve të depistuar të kancerit të gjirit deri në 800 nga 7200 raste të depistuar si dhe do të ofrohen shërbime të kemioterapisë për trajtimin e tyre në spitale rajonale si ai i Beratit;
- Do të intensifikohet puna me mjekët e familjes që të rritet ndërgjegjësimi për kontrollin periodik dhe njëkohësisht do të synohet të rritet numri i burrave të moshës 35-70 vjeç që përdorin shërbimet e check-up për identifikimin në kohë të sëmundjeve, etj.

Politikat shëndetësore do të vijojnë të mbështesin nënat e reja me **Investimet në maternitetet e reja me rreth 508,287,149 lekë.**

6. Arsimi

Fondet për "Sektorin e Arsimit" në vitin 2023, parashikohet të arrijnë në 69 miliardë lekë, ose 3.2% të PBB.

Ofrimi i teksteve shkollore falas për 280 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë

Politikat kryesore për zhvillimin e arsimit gjatë këtij viti synojnë:

- Personeli mësimdhënës në sistemin parauniversitar, ku pjesën më të madhe e zënë gratë, duke rritur pagat në vlerën 7%
- Ofrimi i teksteve shkollore falas për 280 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe ofrimi i bursave financiare apo kuotë ushqimore/financiare për 2800-3000 nxënës me nevoja të veçanta; Tekstet shkollore falas për arsimin e mesëm ku do të përfitojnë dhe vajzat që vijnë nga familje në nevojë dhe/apo viktimat të trafikimit;
- Sigurimi i shërbimit të transportit për 35 mijë fëmijë dhe nxënës (47% e të cilëve janë vajza) që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, si dhe për rreth 12 mijë mësues/e që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë,



- Politikat e punësimit dhe të arsimit profesional për gratë dhe vajzat vijojnë të jenë prioritet për këtë ministri, ashtu sikurse edhe politikat e mbrojtjes sociale të strehimit social apo të sigurimeve shoqërore, të cilat synojnë jo vetëm fuqizimin e grave dhe vajzave, por edhe ndihmën specifike ndaj atyre që janë viktime të dhunës më baza gjinore apo në familje.
- Rritja e fondeve grant për IAL publike "Pakti për Universitetet" dhe ndërkombëtarizimi i

Arsimit të Lartë - fillohet puna për hapjen e filialeve të Universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. Granti nga buxheti për institucionet e arsimit të lartë publik për vitin 2023 kap shifrën e 10.4 miliardë lekë. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet rritjes së numrit të vajzave dhe grave që kryejnë kërkim shkencor në IAL;

- Financimi i politikës "Edukimi nëpërmjet sportit" nëpërmjet klasave

të profilizuara sportive - Do të rritet numri i klasave të profilizuara sportive në mënyrë progresive në të gjithë vendin, nga 223 në 423, duke shtuar edhe disiplina të reja sportive, si gjimnastikë, atletikë dhe tenis me qëllim ofrimin e sporteve gjithëpërfshirëse për të gjitha vajzat dhe djemtë e grupeve të ndryshme sociale. Do të mbështeten veçanërisht federatat e disiplinave sportive të ndryshme duke e çuar fondin e mbështjetes për to në nivelin 240 milionë lekë për vitin 2023.



Do të rritet numri i klasave të profilizuara sportive

në mënyrë progresive në të gjithë vendin, nga 223 në 423

7. Mbrojtja sociale

Buxheti 2023 garanton rritjen e qëndrueshme të mburojës sociale për shtresat në nevojë, me fokus tek fëmijët, nënat më shumë fëmijë, të moshuarit dhe familjet.

Do të rritet financimi i politikës së rishikimit të masës së përfitimit për Ndhmën Ekonomike si dhe politika e mbështetjes së çmimit të energjisë për përfituesit e kategorisë PAK, ku rreth 44% të përfituesve janë gra. Do të vijojnë përpjekjet për të njohur punën e papaguar të grave dhe vajzave në familje duke mundësuar përfitime monetare për disa grupe të rëndësishme sociale.

- Buxheti për programet e mbrojtjes sociale rritet me 5% më shumë krahasuar me buxhetin e rishikuar 2022 duke garantuar mbështetjen e mbi 64 mijë familjeve, pjesë e programit të ndihmës ekonomike, ku rreth 44% të përfituesve janë gra dhe vajza;
- mbështetjen e qëndrueshme të mburojës sociale lidhur me dyfishimin e masës së ndihmës ekonomike për nënat me 2 fëmijë, duke e zgjeruar skemën e mbështetjes krahasuar me vitin 2022 ku mbështeteshin nëna me 3 ose më shumë fëmijë,
- dyfishimin e masës së ndihmës ekonomike për të moshuarit mbi 65 vjeç pa pension pleqërie apo pension social, pjesa më e madhe e të cilëve janë gra nga zonat rurale;
- mbështetjen e programit të pagesave për mbi 164 mijë gra/vajza dhe burra/djem me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët e tyre (pjesa më e madhe e të cilëve janë nënat/

motrat/bashkëshortet etj e këtyre personave);

- për herë të parë sigurohet mbështetje e veçantë për gratë e papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, duke i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri 5 vjeç.
- vijon financimi i Programit të Bonusit të Bebes për cdo të porsalindur, duke garantuar shpërblimin financiar nga 40,000-120,000 lek për mbi 35 mijë fëmijë/vit, si një mënyrë për të ndihmuar sidomos nënat dhe baballarët e rinj që nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e tregut të punës, për të përballuar muajt e parë të lindjes së bebes;
- mbështetja për skemën e pensioneve dhe skemat e tjera të mbështetjes për 801,570 përfitues për vitin 2023 me një total shpenzimesh prej 152.1 miliardë lekë (që mbulohen nga të ardhurat e 789,611 grave dhe burrave kontribues+transfertën nga buxheti;
- mbështetje me pension familjar për 19,588 gra të veja me një kosto prej 3,660,645,008 lekë;
- pagesë për barrë lindje për 17,476 nëna dhe baballarë me një vlerë 4,637,859,999 lekë.

Buxheti për programet e mbrojtjes sociale rritet me 5% më shumë krahasuar me buxhetin e rishikuar 2022 duke garantuar mbështetjen e mbi 64 mijë familjeve

8. Drejtësia dhe rendi

Shpenzimet buxhetore për sektorin e Drejtësisë që janë në masën 39.3 miliardë lekë ose 1.9% të PBB, ndër të tjera do të fokusohen tek:

- Sigurimi i kushteve të përshtatshme të rreth 5,500 të dënuarve burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, si trajtimin me shërbim shëndetësor për 382 të dënuar të sëmurë, me fondin total rreth 1.3 miliardë lekë;
- Financohet me prioritet projekti "Ngritja dhe ndërtimi i institucionit për edukim dhe rehabilitim të të miturve", me një vlerë të plotë të projektit prej 2.4 miliardë lekë, ku për vitin 2023 është planifikuar fondi prej 175 milionë lekë.
- Përmirësimi i trajtimit financiar të Policisë së Burgjeve, si rrjedhojë e rritjes së nivelit të pagave me mesatarisht 14% me fondin shtesë 500 milion lekë, si dhe financimin e blerjes së uniformave të Policisë së Burgjeve;
- Ofrimin e ndihmës juridike falas për 6,300 individë që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, prej të cilëve 3,700 janë gra e vajza në nevojë, me fondin total rreth 91.9 milion lekë;
- Mbikqyrja në mënyrë efektive e 6,880 burrave, 790 grave dhe 186 të



miturve gjatë shërbimit të provës, me një buxhet total prej 155 milion lekë.

- Realizimin e skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit për 1,600 gra dhe burra përfitues me fondin total 4.5 miliard lekë;
- Rritja e nivelit të sigurisë publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet përmes rritjes së numrit të shërbimeve të patrullimit si dhe reduktimit të kohës së reagimit të shërbimeve policore në 13 minuta në vitin 2025;
- Reduktimi i trafiqeve, krimin ndërkufitar dhe rasteve

të imigrimit të paligjshëm kryesisht nëpërmjet reduktimit të kohës së procedimit në 15 minuta në vitin 2025;

- Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje 13 minuta në vitin 2025;
- Rritja e hetimeve proaktive në fushën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave ndaj totalit të hetimeve nga 392 hetime në vitin 2022;
- Rritja e operacione policore mbi hetimet proaktive të realizuara nga strukturat policore, në 38 656 hetime në vitin 2025;

9. Mbrojtja

Buxheti i vitit 2023 i Ministrisë së Mbrojtjes arrin në 40.3 miliardë lekë ose 1.85% të PBB duke synuar financimin e politikave si më poshtë:


- Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakëve gra dhe burra;
- aktiviteti i personelit për 660 ushtarakë të forcave ajrore, 1589 personel i Forcave të Armatosura, ku rreth 17% e tyre janë gra dhe vajza me dhe pa uniform,
- trajtimi i rreth 7322 urgjencave të shtruar tek Spitali i Traumës;
- aktiviteti i 7591 personel i arsimuar sipas kriteve dhe standardeve të NATO-s ku 860 janë gra në uniformë dhe parashikohet të rekrutohen edhe 65 gra dhe vajza të tjera në FA;
- kategoritë përfituese për 21 978 personel ushtarak gra dhe burra në pension;
- Zbatimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, etj, i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë;
- Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione i Forcave të Armatosura.



10. Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare

Shpenzimet për Ministrinë e Kulturës shkojnë në 3.96 miliardë lekë ose 0.2% të PBB, duke synuar financimin e projekteve me rëndësi për ruajtjen e kulturës dhe traditës, bashkëjetesës fetare, zhvillimit të artit në vend dhe shtimin e turizmit kulturor në Shqipëri. Ndër të tjera do të financohet:

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore. Rritja e numrit të objekteve të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura nga 152 në vitin 2022 në 156 në vitin 2025;
- Rritja e aksesit të publikut në muze, monumentet e kulturës dhe parqe arkeologjike në funksion të turizmit kulturor (nr. vizitorësh), nga 210 mijë vizitorë në vitin 2022 në 220 mijë turistë në 2023;
- Rritja e mbështetjes për aktivitetet të fushës së trashëgimisë kulturore nga 175 aktivitete të mbështetura në vitin 2022 në 195 aktivitete deri në 2025;
- Rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e Artit



- Shqiptar në arenën ndërkombëtare, arti në hapësirat publike, Bonusi i Rijetëzimit, mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës librit dhe përkthimit;
 - Rijetësimi i Piramidës Tiranë, projekt me bashkëfinancim me Bashkinë e Tiranës që do të shtrihet përgjatë viteve 2021-2024;
 - Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të Bukura;
 - Projektimi dhe zbatimi
 - i Mozaikut Tiranë, i cili pritet të përfundojë në vitin 2023;
 - Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave;
 - Ndërtimi i Godinës së Teatrit Tiranë.
- Për sektorin e kulturës do të vijohet ti jepet përparësi:
- Grave dhe vajzave artiste që promovojnë skenën e pavarur;
 - Gratë artizane që ruajnë dhe trashëgojnë më tej vlerat dhe traditat e kulturës shqiptare.

11. Mbrojtja e mjedisit

Duke marrë gjithnjë e më tepër vëmendje e rëndësi në mënyrën se si aktivitetet e ndryshme publike ndikojnë në mjedis dhe efektet e ndryshimeve klimatike në jetën e grave dhe burrave, por edhe duke pasur parasysh vendet e reja të punë apo mundësitë e reja në investim për "Green Economy", ky sektor do të financohet me 6 miliardë lekë ose 0.3% të PBB dhe do të fokusohet ndër të tjera edhe në:

- Arritja e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit;
- Përmirësimi i performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në 20%;
- Rritja e përqindjes së mbetjeve që shkojnë në landfille sanitare kundrejt mbetjeve të hedhura në venddepozitime të hapura në 60%;
- Rritja e kontributit direkt që ka Turizmi në Produktin e Brendshëm Bruto;
- Promovimi i turizmit, nëpërmjet pjesëmarrjes në pancaire ndërkombëtare, me një kosto rreth 72 milionë lekë;
- Rritja e të punësuarve në sektorin e turizmit në 29%;
- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor;



12. Strehimi

Në këtë sektor do të vijojnë shpenzimet për mbështetjen e rindërtimit të shtëpive të dëmtuara nga tërmeti i 2019 si dhe ndërtimi i banesave për strehimin e grave dhe burrave nga grupet sociale në nevojë. Shpenzimet për programet e strehimit parashikohen në 2.5 miliardë lekë duke u fokusuar në:

- Pagesë për bonus qiraje për familjet, banesat e të cilave preken nga projekti i Unazës së Madhe në vlerën 150 milionë lekë;
- Skemat e investimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës për gra dhe burra nga grupet sociale në nevojë ku 174 janë gra/vajza ose 7.2% e totalit të përfituesve me një kosto prej 534,713,429 lekë;

Nëpërmjet instrumentit të Garancisë Sovrane në vlerën 1.5 miliardë lekë të parashikuar për vitin 2023, Qeveria Shqiptare synon të mbështesë rreth 1000 përfitues që punojnë në administratën publike, kryesisht në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe rendit publik, të cilët kanë krijuar një familje të re dhe kërkojnë të blejnë një shtëpi të parë. Nëpërmjet këtij instrumenti, kjo kategori përfituesish do t'ju mbulohet me garanci të kontributit të huamarrësit (down payment) që përbën rreth 20-30% të koston totale të shtëpisë së blerë, përgjatë gjithë periudhës së shlyerjes së kredisë për shtëpi.



Nëpërmjet instrumentit të Garancisë Sovrane në vlerën 1.5 miliardë lekë të parashikuar për vitin 2023, **Qeveria Shqiptare synon të mbështesë rreth 1000 përfitues që punojnë në administratën publike**, kryesisht në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe rendit publik

Deficiti Buxhetor dhe Borxhi Publik

Deficiti buxhetor për vitin 2023 parashikohet të ulet në nivelin **2.6% të PBB** nga **3.3% të PBB** që pritet deri në fund të vitit 2022, dukshëm i orientuar drejt financimit të investimeve publike të parashikuara

për vitin 2023. Në fund të vitit 2025, niveli i deficitit buxhetor parashikohet të ulet në **2.2% të PBB** duke përmbyshur kështu objektivin madhor të Qeverisë për uljen graduale të stokut të borxhit publik.

	2017	2018	2019	2020	2021	2022*
<i>Balanca fiskale, (në % ndaj PBB)</i>						
Shqipëria	-2.0	-1.6	-1.9	-6.7	-4.5	-3.3
Bosnja dhe Hercegovina	2.6	2.2	1.9	-5.3	3.5	n.a
Kosova	-1.3	-2.9	-2.9	-7.6	-1.3	n.a
Maqedonia	-2.7	-1.8	-2.0	-8.2	-5.4	-6.1
Mal i Zi	-5.3	-3.9	-2.0	-11.1	-1.9	-4.4
Serbia	1.1	0.6	-0.2	-8.0	-4.1	-3.1
Mesatarja e rajonit	-1.3	-1.2	-1.2	-7.8	-2.3	n.a

Borxhi publik për vitin 2022 është në nivelin 68.9% ndaj PBB, brenda mesatares së rajonit.

	2017	2018	2019	2020	2021	2022*
<i>Borxhi publik dhe i garantuar (në % ndaj PBB)</i>						
Shqipëria	70.2	67.7	65.8	74.5	73.2	68.9
Bosnja dhe Hercegovina	36.1	34.1	32.8	36.6	35.4	n.a
Kosova	16.4	17.0	17.6	22.4	21.9	n.a
Maqedonia	39.4	40.4	40.5	51.9	51.8	54.6
Mal i Zi	63.3	70.1	76.5	105.3	83.3	76.7
Serbia	59.2	53.7	52.0	57.0	56.5	54.5
Mesatarja e rajonit	44.7	44.8	45.5	58.0	54.0	n.a



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË